



Tiranë, më 20.12.2019

**Shpalljen e vendeve vakant të një pedagogu me gradën Doktor i Shkencave në fushën e Ndërtimit me këto karakteristika:**

- Arkitekt (300 ECTS)
- Inxhinier Ndërtimi (konstruktor)
- Inxhinier për Paisje dhe Teknologjitë e Ndërtesës – Inxhinier Mekanik
- Inxhinier Elektrik – Eficienca e Energjisë

- a. Teknik në ndërtimtari për ndërtim dhe rifinitura
- b. Teknik në sistemet dhe teknologjitë e ndërtesës
- c. Teknik në mekanikë dhe prodhim të automatizuar
  - Në kuadër të procesit të plotësimit të personelit akademik të Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit kërkojmë të punësojmë personal akademik efektiv me këto karakteristika:
  - Personel akademik efektiv pranë Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit.
  - Kandidati të ketë si përgjegjësi zbatimin e të gjitha detyrimeve që përcaktohen në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe zbatimin e detyrimeve që përcaktohen në statutin dhe rregulloret e SHLUIJ "Universitetit Marin Barleti" për pozicionin që do të mbulojë.
  - Të jetë i diplomuar në fushën e Arkitekturës / Inxhinierisë së Ndërtimit / Dizajnit.

**Kërkesat për kandidatët:**

- Të ketë së paku gradën shkencore "Doktor"
- Të ketë përvojë në mësimdhënie në fushën e Ndërtimit,
- Të ketë përvojë në kërkimin shkencor;
- Të ketë përvojë për hartimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme (aplikativ).
- Të ketë përvojë pune të paktën 10 vjeçare,
- Të jetë njohës i të paktën një gjuhe të huaj.

**Procedura e aplikimit:**

Kandidatët aplikues, **deri në datën 8 janar 2020**, duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në "Universiteti Marin Barleti" (në formë të printuar) si dhe në adresën elektronike [hr@umb.edu.al](mailto:hr@umb.edu.al), dokumentacionin e mëposhtëm:



- Kopje të noterizuar të diplomave dhe listës së notave të studimeve universitare dhe pasuniversitare;
- Një CV të përditësuar, në gjuhën shqipe dhe angleze, në formatin Europass;
- Një letër interesi për pozicion për të cilin aplikon;
- Dy kontakte reference. (opcionale)

Vetëm personat që plotësojnë kriteret e vendosura më sipër do të kontaktohen.

Të dhënat e aplikantëve mblidhen, përpunohen dhe trajtohen në mënyrë konfidenciale në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".